

male, mi të cilat shiu, djelli edhe axhentët e tjerë bëjnë punën e tyre dërmonjëse dyke ja u transformuar natyrën të egërtë, me gjith që do shkojë shumë kohë edhe gjer sa të arrinë në formën e kodrave të rrumbullakia.

Bujku në Mirditë ndodhet në një pozitë të keqe sepse duhet të punojë më një tokë të ngushtë, që është plot gurrë, dhe që vjen skërkë. Meqënëse toka ndodhet në rëzë të malit, shiu e shplan dhen' e butë dhe e rëzon poshtë ke lumënjtë kështu që ara dobësohet edhe nuk prushon mjaft. Shumë herë bien nga malet edhe gurriçka të cilat e mbushin tokën edhe me këtë mënyrë të punuarit e saj bëhet e fëshirë. Pastrohen nga gurrër, mirëpo bien prapë edhe kjo punë vazhdon "ad infinitum".

Toka e pakët që është rafsh ndodhet gjatë lumënjvet edhe përonjvet, të cilët kanë depoziuar dhënë që është rëzuar prej shiut nga malet.

Dyke mos marrë parasysh disa shtëpi të mëdha edhe manastiret, një shtëpi mesatare munt të ketë një vënt pe 3-5 pendë që, i cili munt t' i japë 10-12 barë kollomboq (1000-1200 kile). Për një shtëpi me shumë misa kjo tokë nuk munt të jetë e mjaftë për bukën e motit.

Arat edhe luadhet janë rëth e rrotull shtëpisë së tij; toka lërohet me parmëndë që e heqin qetë, dhe shtëpia që nuk ka që munt të marrë